




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr.14/350-56883 datë: 13.01.2021
REFERENC-Ë:	07Nr.350/56883 datë: 26.11.2020
PËR/to:	Cima SH.P.K, me përfaqshues Bali Kabashin Krushica e Poshtme - Suharekë
KOPJE/copy:	Drejtorinë e Inspeksionit, Dosje të Drejtorisë
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI REXHEPAJ Zyrtare e lartë për ndërtimtari: Doruntina Bytyqi ing.dipl.ndërt
LËNDA/SUBJECT:	Aktvendim mbi Lejen Ndërtimore

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr.350/56883 datë:26.11.2020 nga **Cima SH.P.K, me përfaqshues Bali Kabashin**, për Leje Ndërtimore për objektin me destinim Banim dhe afraizëm, me etazhitet 2B+P+6+PH, në parcelat kadastrale 1070-13 pronë e Drita Sopaj sipas çertifikatës 1972/2020 datë:08.07.2020, 1070-12 pronë e Zenun Veselaj sipas çertifikatës 1972/2020 datë:08.07.2020, 1073-9 pronë e Avdi Elshani sipas çertifikatës 1972/2020 datë:08.07.2020 dhe 1070-15 pronë e Avdi Elshani, Myrvete Bytyqi dhe Drita Sopaj sipas çertifikatës 2204/2020 datë:21.07.2020, 1072-6 Pronë Shoqërore Shfrytëzues i Përhershëm Ismet Kuqi sipas çertifikatës 1972/2020 datë:08.07.2020, 1073-7 Pronë Shoqërore Shfrytëzues i Përhershëm Ismet Kuqi sipas çertifikatës 1972/2020 datë:08.07.2020, 1073-8 pronë e Avdi Elshani sipas çertifikatës 1972/2020 datë:08.07.2020, 1073-6 pronë e Avdi Elshani sipas çertifikatës me nr.1972/2020 datë:08.07.2020 dhe 1073-11 pronë e Avdi Elshani sipas çertifikatës me nr.1972/2020 datë:08.07.2020. Sipas kontratës për bashkinvestim me Nr.LRP 2902/2017-Nr.i Ref.564/2017 të datës:07.06.2017, Nr.LRP 3372/2018-Nr.Ref.563/2018 datë:28.05.2018, Nr.LRP 3031/2020-Nr.Ref.859/2020 datë:28.05.2018 si dhe kontratës Nr.LRP 3027/2020-Nr.Ref.855/2020 datë:28.07.2020, andaj pas shqyrtimit të lëndës ky organ vendosi, si në Aktvendimin e bashkangjitur kësaj shkrese.

• **AKTVENDIM MBI LEJEN NDËRTIMORE**



Data:13.01.2021

Numri i vrojtimit të lejes:

07Nr.14/350-56883

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas PPrU "Pojata" 01Nr.16-569 datë 01.02.12, Vendimit 01-Nr-16-1413 datë:28.03.2011 neni 2, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga Cima SH.P.K, me përfaqësues Bali Kabashi nga Suhareka, DUP lëshon këtë:

AKTVENDIM (MBI LEJE NDËRTIMORE)

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Cima SH.P.K, Me përfaqësues Bali Kabashi	Nr. Personal:	
Adresa:	Krushicë e Poshtme, Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje ndërtimore: 07Nr.350-56883 datë:26.11.2020

Emri i Projektit:	OBJEKT AFARISTO-BANESOR		
Emri i Projektuesit:	"Cima SH.P.K" Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar		
Adresa:	Fushe Kosove		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI, KATEGORIA II			
Adresa: Rr." Hajdin Berisha"-SUHAREKË			
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:	
1972/2020 datë:08.07.2020 dhe 2204/2020 datë:21.07.2020, prona të Drita Sopaj, Zenun Veselaj, Avdi Elshani, Myrvete Bytyqi dhe Ismet Kuqi, sipas Kontratave për bashkinvestim Nr.LRP2902/2017-Nr.iRef.564/2017 datës:07.06.2017, Nr.LRP3372/2018-Nr.Ref.563/2018 datë:28.05.2018, Nr.LRP 3031/2020-Nr.Ref.859/2020 datë:28.05.2018 dhe Nr.LRP 3027/2020 - Nr.Ref. 855/2020 datë:28.07.2020.	1070-13, 1070-12, 1073-9, 1070-15, 1072-6, 1073-7, 1073-8, 1073-6, 1073-11	Y= 7486135.746 Y= 7486134.975 Y= 7486142.137 Y= 7486140.422 Y= 7486155.886 Y= 7486161.371 Y= 7486163.28 Y=7486155.603	X=4691462.883 X=4691475.73 X=4691476.159 X=4691504.409 X=4691501.629 X=4691501.957 X=4691470.144 X=4691464.074

Lloji i ndërtimit të propozuar:			
Objekt Banim-Afarizëm			
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:			
Kategoria II			
Gabariti:	(27.92m' x 18.97m') (20.74m' x 25.25m')	Katshmëria:	2B+P+6+PH me sipërfaqe bruto të objektit sipas llogaris në taksen administrative 9815.06m².
Vija rregullative:	Nga aksi i rrugës së planifikuar "Brigada 123" 16.0m'(për profilin tërthorë të rrugës 32m)	Vija ndërtimore:	Nga vija rregullative nga rruga ekzistuese për përdhese "Brigada 123" 8.0m' Nga vija rregullative nga rruga ekzistuese për bodrum "Brigada 123" min.7.0m'

Përshkrimi

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Cima SH.P.K, me përfaqësues Bali Kabashi** i lejohe ndërtimi i objektit me destinim banim-afarizëm me etazhitet 2B+P+6+PH.

Lokacioni i objektit është në kuadër të PRrU "Pojata" 01Nr.16-569 datë 01.02.12, ku sipas gjendjes së planifikuar, në parcelat kadastrale 1070-13, 1070-12, 1073-9, 1070-15,1072-6,1073-7,1073-8,1073-6,1073-11 është tokë ndërtimore në tërsinë urbane BL I –D ZQP (Zonë Qëndrore e Përzier), ndërsa sipas Planit Zhvillimor Urban-Zonë Qëndrore Banimore, sipas Projektit kryesor hartuar nga: "CIMA SHPK" Fushë Kosovë.

Objekti ka karakter të përhershëm me katëshmëri 2B+P+6+PH. Ndërtimi i objektit të bëhet konform Njoftimit rreth Kushteve Ndërtimore të lëshuara nga ky organ: 07Nr.415/350-40088 datë 05.10.2020 Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të "APROVUAR" nga organi kompetent;
 - Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;

- Librin dhe ditarine ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;

Duhet të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore dhe Kod. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore. Në rast të mos respektimit të Njoftimit rreth Kushteve ndërtimore, Lejes së ndërtimit si dhe në çdo parregullsi që haset në teren inspektori përgjegjës duhet të njoftoj me shkrim organin kompetent në mënyrë që të veprohet në përputhje me dispozitat ligjore. Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.

- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveç në rastet kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftojë organet komunale.
- Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportojë në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, në lokacionin e përcaktuar nga Kuvendi i Komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore dhe pranimi teknik të të gjitha fazave, të aplikojë për certifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin dhe aktet nënligjore.

Ar s y e t i m

Aplikuesi **Cima SH.P.K, me përfaqësues Bali Kabashi**, përmes kërkesës 07Nr.350/56883 datë: 26.11.2020, ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejes Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim banim-afarizem, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim rreth Kushteve Ndërtimore 07Nr.415/350-40088 datë 05.10.2020 (kopje)
- Akvendimeve të lejeve të rrënimit 07Nr.406/350-40086 datë 01.10.2020, 07Nr.404/350-40089 datë 01.10.2020, 07Nr.405/350-42761 datë 01.10.2020.
- Pëlqim për largimin e mbeturinave Nr.163/20, datës:16.10.2020 lëshuar nga NPRM “ ECO-REGJIONI”- Prizren, Njësia operative Suharekë.
- Vlerësim për kyqje në rrjetin publik të Ujësjellësit dhe Kanalizimit–Hidroregjioni Jugor

Faqe 4 nga 5

Prizren Nr.2867 datë:24.11.20.

- Pëlqim Sanitar-nga Inspektori i Sanitarisë 09Nr.2071 datë:19.11.2020.
- Pëlqim për kushtet e sigurisë në komunikacion rrugor-nga Inspektori i Komunikacionit Rrugor 09Nr.2069 datë:19.11.2020.
- Pëlqim për rregullim të dokumentacionit teknik, KEDS-SH.A, Nr.1357, datë:18.11.2020.
- Pëlqim në dokumentacion teknik mbi masat e parapara për mbrojtje nga zjarri, Ministria e Punëve të Brendshme, Agjensia e Menagjimit të Emergjencave Nr.353/20, datë:16.11.2020.
- Lejen Mjedisore Komunale 03Nr.584/181-53756 datë 21.12.2020
- Kordinatat e vendosjes së objektit sipas skicës së terenit Nr.P.142/20 datë 22.11.2020 të punuar nga gjeodeti i licensuar Adriatik Fetiu.
- Pëlqimin nga Resmije Bektoshi pronare e parcelave fqinje 1072-5, 1073-4 dhe 1074-2 Nr.LRP.4948/2020 datë:01.10.2020.
- Elaborati gjeomekanik
- Projekti i ashensoreve
- Akvendimin mbi formimin e komisionit profesional 01-Nr-016-78723 dt:09.12.2020 nga Zyra e Kryetarit të Komunës sipas kërkesës 01Nr.104-58482 datë 08.12.2020.
- Raportet e anëtarëve të komisionit konform formularëve standard të udhëzimit administrativ 06/2017 datë 23.05.2017.
- Tri kopje të projektit zbatues dhe kopje elektronike
- Kopje e planit dhe çertifikata e pronësisë
- Vërtetimin e tatimit në Pronë
- Kopje e dokumentit Identifikues

Ky organ përmes shërbimit të vet profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse, bazuar në Ligjin Nr.04/L-110 për Ndërtim, konform PRrU Pojata 01Nr.16-569 datë 01.02.12, Vendimit 01-Nr-16-1413 datë:28.03.2011 neni 2, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Sipas Njoftimit 07Nr.541/350-56883 datë 15.12.2020, parashtruesit të kërkesës i është caktuar lartësia e pagesës për leje ndërtimore në shumën prej 34,642.96 € dhe se për pagesën e kryer janë sjellë dëshmia nga Raiffeisen Bank me datë 22.12.2020, sipas faturës komunale nr.0000615 të datës 17.12.2020.

Udhëzim juridik: Kundër kësaj Leje Ndërtimore pala e pakënaqur mund t'i paraqitet ankesë MEA në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e dorëzimit përmes këtij Organi.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim – Komuna Suharekë

Numri i vrojtimit i lejes 07Nr.14/350-56883 datë:13.01.2021

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Inspektoratit të Komunës;
- Dosjes së DUP-së

Drejtori i Drejtorisë:
Sanie KUOLREXHEPAJ

Faqe 5 nga 5

Adresa: Objekti i Kuvendit Komunal, Kati i Parë, nr: 026, Suharekë – Kosovë | telefon: 029/271 518
www.komuna-suhareke.org. E-mail: urbanizmi@suhareke@rks-gov.net